FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr.158 10 dhjetor 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 804, datë 21.11.2012	Për lejimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe drejtorive rajonale të Autoritetit Rrugor Shqiptar, si autoritete kontraktore, për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave të mirëmbajtjes dimërore dhe rutinë……	8539
Urdhër i MBUMK nr. 316, datë 31.10.2012	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 5, datë 9.1.2012 "Për përditësimin e certifikatave veterinare, të cilat shoqërojnë ngarkesat e ushqimeve me origjinë shtazore, si dhe ngarkesat e ushqimeve për kafshë prodhuese të ushqimit, dhe të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë"……	8541
Vendim i BSH nr. 63, datë 14.11.2012	Për miratimin e rregullores "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja, dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre" ……	8542

VENDIM
Nr. 804, datë 21.11.2012

PËR LEJIMIN E AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR DHE DREJTORIVE RAJONALE TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR, SI AUTORITETE KONTRAKTORE, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE LIDHJEN E KONTRATAVE TË MIRËMBAJTJES DIMËRORE DHE RUTINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe drejtorive rajonale të këtij Autoriteti, përkatësisht Drejtoria e Rajonit Qendror (Tiranë), Drejtoria e Rajonit Verior (Shkodër) dhe Drejtoria e Rajonit Jugor (Gjirokastër), si autoritete kontraktore, që, brenda datës 20 dhjetor 2012, të kryejnë procedurat e prokurimit për objektet e përcaktuara në listat 1 e 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Qendror (Tiranë), Drejtoria e Rajonit Verior (Shkodër), Drejtoria e Rajonit Jugor (Gjirokastër) dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA 1
Autoriteti kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar

1. Supervizion punimesh, ndërtim Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - Rr. e Kavajës), loti 1

LISTA 2
Autoriteti kontraktor: Drejtoria e Rajonit Verior (Shkodër)

1. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, autostrada Rrëshen - Tunel Thirrë (55 km)
2. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, autostrada Tunel Thirrë - Morinë (42 km)
3. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Ura e Topojanit - Peshkopi - Maqellarë Bllatë (24 km)
4. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Q.Bualli - Ura e Topojanit (30 km)
5. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Ura Cerenecit - Steblevë (39 km)
6. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Kr.Rr. e Kombit - Skuraj - Ulëz dhe Burrel - Qafë - Bualli (71 km)
7. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Kolsh - Q.Shllak (41 km)

8. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Kukës - Daj Rec (26 km)

9. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Plepa - Kamë (23 km)

10. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor B.Curri - Kamë (43 km)

11. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor B.Curri- Fierzë (17 km)

12. Mirëmbajtje dimërore me performancë segmenti rrugor B.Curri - Sopot - Kufi (Q.Morinë) (20 km)

13. Mirëmbajtje dimërore me performancë segmenti rrugor B.Curri - Valbonë (27 km)

14. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Domaj - Ura e Lapajve - Bushtricë (19 km)

15. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë segmenti rrugor Kukës - Ura e Zapotit (15 km)

16. Mirëmbajtje dimërore me performancë, segmenti rrugor Krumë - Qafë - Prushi (17 km)

17. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Qafë - Cele - Pukë (28 km)

18. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Pukë - Fushë - Arrëz (19.5 km)

19. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Fushë - Arrëz - K/Qafë Mali - Q. Shllak (23.2 km)

20. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Ura e Matit - Rrëshen (24 km)

Autoriteti kontraktor: Drejtoria e Rajonit Qendror (Tiranë)

1. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Tiranë - K/Dajt - Antena (22 km)

2. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor K/Dajt - Bizë + Q.Priskë - Shëngjergj (76 km)

3. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Tiranë - Km 29 (Kaçolitë) - Elbasan (19 km)

4. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Elbasan - Gjinar (24 km)

5. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Xibrakë - Qafë-Thanë (51 km)

6. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, segmenti rrugor Librazhd - Steblevë (32 km)

7. Shembje masive e rrugës Shalës km 74 + 150, segmenti rrugor K/Cërrik - Shalës - Belsh

Autoriteti kontraktor: Drejtoria e Rajonit Jugor (Gjirokastër)

1. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, rruga Vlorë - Borsh (10 km)

2. Mirëmbajtje dimërorë dhe rutinë me performancë, rruga K/Jorgucat – Qafë - Muzinë - Sarandë (15 km)

3. Mirëmbajtje dimërore me performancë, rruga Korçë - Petrush (25 km)

4. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, rruga Korçë - Qafë-Qarri (22 km)

5. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, rruga Korçë - K/Progër (18 km)

6. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, rruga K/Progër - Kapshticë (18 km)

7. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, rruga Libonik - Lozhan - Grabovë + rruga K/Boboshticë - Dardhë + rruga Korçë - Voskopojë (50 km)

8. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, rruga Pogradec - Petrush + Pogradec - Drilon - Doganë Tushemisht (25 km)

9. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, rruga Qafë-Qarri - Ersekë - Leskovik (48 km)

10. Mirëmbajtje dimërore dhe rutinë me performancë, rruga K/Podgorie (Lapidari) - Korit + rruga Korit - K/Rr. Liqenas (20 km)

URDHËR
Nr. 316, datë 31.10.2012

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 5, DATË 9.1.2012 "PËR PËRDITËSIMIN E CERTIFIKATAVE VETERINARE, TË CILAT SHOQËROJNË NGARKESAT E USHQIMEVE ME ORIGJINË SHTAZORE, SI DHE NGARKESAT E USHQIMEVE PËR KAFSHË PRODHUESE TË USHQIMIT, DHE TË CILAT HYJNË NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 18 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin",

URDHËROJ:

1. Urdhri nr. 5, datë 9.1.2012 "Për përditësim e certifikatave veterinare, të cilat shoqërojnë ngarkesat e ushqimeve me origjinë shtazore, si dhe ngarkesat e ushqimeve për kafshë prodhuese të ushqimit dhe të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në përputhje me nevojat e tregut.

2. Drejtoria e Shërbimit Veterinar dhe Drejtoria e Sigurisë Ushqimore të ndjekin procedurat për njoftimin e këtij urdhri pranë autoriteteve homologe të vendeve anëtare të OIE-së, si dhe pranë OBT-së.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Drejtoria e Sigurisë Ushqimore, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

VENDIM
Nr. 63, datë 14.11.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI PARIMET BAZË TË DREJTIMIT TË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA, DHE KRITERET PËR MIRATIMIN E ADMINISTRATORËVE TË TYRE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 24 pika 1 shkronja "c" dhe "ë" dhe pika 2 shkronja "b"; të nenit 40 shkronja "c" dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 40, datë 27.5.2009, shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
MBI PARIMET BAZË TË DREJTIMIT TË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA DHE KRITERET PËR MIRATIMIN E ADMINISTRATORËVE TË TYRE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është:

a) përcaktimi i parimeve dhe rregullave bazë për një drejtim të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave dhe degëve të bankave të huaja;

b) përcaktimi i kërkesave për një sistem efektiv të administrimit të rrezikut, përfshirë edhe rrezikun e përputhshmërisë;

c) përcaktimi i kërkesave minimale për hartimin, zbatimin dhe publikimin e politikës dhe të skemës së shpërblimit;

d) përcaktimi i kritereve që duhet të përmbushin administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja, dhe i dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e tyre nga Banka e Shqipërisë; si dhe

e) përcaktimi i kritereve për lidhjen e marrëveshjeve me të tretët për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive për administrimin dhe drejtimin e bankës.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë (këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhen "banka").

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 24 pika 1 shkronja "c" dhe "ë" dhe pika 2 shkronja "b"; nenit 40 shkronja "c" dhe nenit 42 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Plani për vazhdimësinë e aktivitetit të bankës" është tërësia e masave të hartuara nga banka ose dega e bankës së huaj për të siguruar, sipas skenarëve në rastin e situatave të ndryshme të krizave, vazhdimësinë e aktivitetit kryesor të bankës, pavarësisht mosfunksionimit të shërbimeve të ofruara nga të tretët.

b) "Rreziku i përputhshmërisë" është mundësia që banka të pësojë humbje financiare ose të humbasë reputacionin si rezultat i moszbatimit, i shkeljeve apo i mos përputhshmërisë me ligjet, rregullat, rregulloret, praktikat bankare, politikat dhe procedurat e brendshme, si dhe standardet e etikës së biznesit.

c) "Toleranca e rrezikut" është niveli i rrezikut që banka është në gjendje dhe dëshiron të ndërmarrë në përmbushje të objektivave të biznesit.

d) "Drejtues joekzekutiv" është anëtari i Këshillit Drejtues, i cili nuk është pjesë e drejtimit ekzekutiv të bankës.

KREU II
PARIMET DHE RREGULLAT BAZË TË DREJTIMIT TË PËRGJEGJSHËM DHE EFEKTIV

Neni 5
Organet drejtuese dhe kultura e përgjithshme e drejtimit

1. Këshilli drejtues dhe drejtoria, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive që lidhen me drejtimin dhe kontrollin e bankës, njohin në mënyrë të plotë dhe të qartë profilin e rrezikut të

bankës, duke përcaktuar/miratuar paraprakisht ndërmarrjen dhe tolerancën së tij (rrezikut), ndjekjen në vazhdimësi të tij në përputhshmëri me këto të fundit, duke siguruar që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm këtë rrezik.

2. Këshilli drejtues dhe drejtoria, nëpërmjet mënyrës së drejtimit, nxisin (stimulojnë) një kulturë të përshtatshme drejtimi, e cila ka për përparësi ndershmërinë dhe krijimin e marrëdhënieve korrekte ndërmjet nëpunësve, të bazuar në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike.

3. Këshilli drejtues në bashkëpunim me drejtorinë, marrin masa për arritjen e standardeve të larta etike dhe profesionale në drejtimin e bankës.

4. Banka siguron që, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, njohuritë, eksperiencat dhe kualifikimet e anëtarëve të këshillit drejtues të ndërthuren njëkohësisht me njëra-tjetrën, në mënyrë që të krijohet një kualifikim kolektiv, i përshtatshëm i këshillit drejtues.

Neni 6
Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues, në funksion të drejtimit të bankës në përputhje me objektivat, strategjitë dhe politikat e miratuara, si dhe në interesin më të mirë të saj, shqyrton dhe vlerëson:

a) zhvillimin dhe mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të ekspertizës profesionale në përputhje me rritjen dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës;

b) sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare të bankës;

c) njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

d) parandalimin dhe shmangien e konflikteve të mundshme të interesit në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e bankës; si dhe

e) mbrojtjen e interesave të klientëve, investitorëve dhe të publikut në përgjithësi.

2. Këshilli drejtues drejtohet nga kryetari, i cili është përgjegjës për funksionimin efektiv të tij (këshillit), duke përfshirë edhe mbajtjen në vazhdimësi të një marrëdhënieje besimi me anëtarët e tij, me qëllim që të sigurojë:

a) marrjen e vendimeve mbi një bazë të shëndoshë dhe të mirinformuar;

b) inkurajimin dhe promovimin e diskutimeve kritike; dhe

c) shprehjen e pikëpamjeve kundërshtuese, si dhe zhvillimin e diskutimeve në kuadër të procesit të vendimmarrjes.

Neni 7
Drejtoria

1. Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës.

2. Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat te personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara.

3. Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka, në përputhje me strategjitë e miratuara.

4. Drejtoria zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.

Neni 8

Efektiviteti i punës së këshillit drejtues dhe bashkëpunimi i organeve drejtuese

1. Këshilli drejtues informohet rregullisht nga drejtoria, në mënyrë të plotë dhe në kohën e duhur, për çështjet e rëndësishme që lidhen me operacionet e bankës, në veçanti, për administrimin e rrezikut, zbatimin e strategjive dhe politikave, si dhe për çdo shmangie nga objektivat e miratuar.

2. Këshilli drejtues, në bashkëpunim/konsultim me drejtorinë, merr vendime në interesin më të mirë të bankës, të cilat ndikojnë në drejtimin dhe kontrollin e kujdesshëm të saj, lidhur me çështjet e mëposhtme:

a) objektivat e veprimtarisë;

b) politikat dhe udhëzimet për arritjen e këtyre objektivave;

c) strategjitë për ndërmarrjen e rreziqeve dhe administrimin e tyre; si dhe

d) analizat lidhur me profilin e rrezikut.

3. Këshilli drejtues, mbështetur në raportet, analizat dhe informacionet e marra nga drejtoria, rishikon rregullisht politikat e miratuara dhe vlerëson, në vazhdimësi, përshtatshmërinë e tyre me zhvillimet e bankës dhe të tregut.

4. Këshilli drejtues dhe drejtoria përdorin në mënyrë efektive informacionet dhe konkluzionet e marra nga njësia ose sistemi i kontrollit të brendshëm, eksperti kontabël i autorizuar dhe struktura të tjera të kontrollit të bankës.

Neni 9

Autonomia e administratorëve

1. Administratorët, brenda kompetencave të përcaktuara nga ligji, aktet nënligjore dhe organet drejtuese, vlerësojnë dhe marrin në mënyrë të pavarur dhe objektive, vendime lidhur me veprimtarinë e bankës.

2. Në zbatim të përcaktimeve të paragrafit 1 të këtij neni, administratori merr në konsideratë të gjithë informacionin e vlefshëm, të mjaftueshëm dhe të plotë, si dhe faktorë të tjerë përkatës që mund të ndikojnë në këto vendime.

Neni 10

Komitetet e krijuara nga këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues, në përputhje me natyrën, madhësinë, kompleksitetin e veprimtarisë dhe profilin e rrezikut të bankës, mund të krijojë komitete të specializuara në nivel këshilli drejtues, të tilla, si: komiteti i rrezikut/qeve, komiteti i shpërblimeve, komiteti i emërimeve etj., të cilat këshillojnë/asistojnë këshillin për çështje të veçanta.

2. Krijimi i komiteteve bëhet me vendim të këshillit drejtues, në të cilin përcaktohet në mënyrë të qartë, qëllimi i krijimit, mandati, përbërja dhe rregullat e funksionimit të komitetit.

3. Çdo komitet i krijuar nga këshilli drejtues sipas këtij neni përbëhet nga një kryetar dhe të paktën dy anëtarë.

4. Bankat publikojnë në raportet e tyre vjetore, emrat e komiteteve të krijuara nën varësinë e këshillit drejtues, mandatet dhe përbërjen e tyre.

KREU III
SISTEMI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT, FUNKSIONI I PËRPUTHSHMËRISË DHE POLITIKA E SHPËRBLIMIT

Neni 11
Kërkesa të përgjithshme

1. Bankat krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre.

2. Sistemi i administrimit të rreziqeve është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të bankës, që shërbejnë për administrimin e rrezikut.

3. "Sistemi i administrimit të rrezikut" përfshin:

a) procesin e identifikimit, të matjes, të monitorimit, të kontrollit dhe të raportimit të të gjitha rreziqeve brenda një banke, në të gjithë aktivitetin e saj (për të gjithë bilancin, portofolin dhe linjat e biznesit);

b) përcaktimin e funksioneve të strukturave të administrimit të rrezikut, të cilat sigurojnë:

i) identifikimin e të gjitha rreziqeve në bankë;

ii) vlerësimin e rreziqeve dhe matjen e ekspozimit ndaj tyre;

iii) monitorimin e ekspozimit të rrezikut dhe përcaktimin e nevojave për kapital në mënyrë të vazhdueshme;

iv) monitorimin dhe vlerësimin e vendimeve për pranimin e rreziqeve të caktuara, masat për zbutjen e rrezikut dhe nëse vendimet janë në përputhje me vendimet e këshillit drejtues për politikat e rrezikut dhe tolerancës së rreziku;

v) raportimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur, në këshillin drejtues, si dhe te drejtuesit ekzekutivë, të të gjitha çështjeve të përcaktuara më lart.

Neni 12
Politikat, rregullat dhe procedurat e brendshme të bankës

1. Bankat, në hartimin e politikave për administrimin e rrezikut, sigurojnë që këto politika të jenë të zbatueshme, të kuptueshme dhe të mirëpërcaktuara për çdo njësi/strukturë të bankës.

2. Politikat për administrimin e rrezikut duhet të përfshijnë minimalisht elementet e mëposhtme:

a) strukturën organizative dhe objektin e funksionit të administrimit të rrezikut;

b) metodën e matjes së rrezikut;

c) detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës/ave të administrimit të rrezikut;

d) strukturën dhe frekuencën e mbledhjeve të komitetit të administrimit të rrezikut;

e) metodën e vendosjes/përcaktimit të kufijve/normave të rrezikut dhe procedurat në rastet e shkeljes së këtyre kufijve/normave;

f) mënyrën e informimit dhe procedurat e raportimit;

g) miratimet dhe/ose konfirmimet, që duhet të jepen në rrethana të veçanta.

3. Bankat sigurojnë që politikat e administrimit të rrezikut të përshtaten në mënyrën e duhur me strukturën e bankës, duke u kujdesur në veçanti që:

a) sistemet e administrimit të rrezikut, si në baza individuale dhe të konsoliduara, të jenë të kuptueshme nga drejtimi i lartë dhe personeli i bankës;

b) strategjitë e administrimit të rrezikut marrin në konsideratë balancën/raportin midis rreziqeve të ndryshme dhe kapitalit të bankës;

c) rreziqet në veprimtarinë kryesore/bazë të bankës janë të diversifikuara; dhe

d) janë ndërmarrë masat e nevojshme për monitorimin e efekteve negative të rreziqeve sistemike, që rrjedhin nga sistemet e pagesave (të cilat mund të shkaktohen nga banka të veçanta që operojnë në treg) dhe ndikojnë në stabilitetin e sistemit.

4. Bankat, në funksion të zbatimit të politikave për administrimin e rrezikut, hartojnë rregulla dhe procedura të brendshme.

Neni 13
Struktura e administrimit të rrezikut

1. Bankat, në varësi të veprimtarisë dhe profilit të rrezikut, krijojnë një strukturë/njësi të veçantë për kryerjen e funksionit të administrimit të rreziqeve, si dhe emërojnë një drejtues ekzekutiv për administrimin e rrezikut.

2. Bankat, në varësi të natyrës, madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë së tyre, ndajnë rolin e drejtuesit ekzekutiv të administrimit të rrezikut nga ai i drejtuesve që mbulojnë funksione të tjera në bankë.

3. Në rastet kur karakteristikat e bankës dhe sidomos madhësia, organizimi dhe natyra e aktiviteteve të saj, nuk e justifikojnë emërimin e një drejtuesi ekzekutiv në funksionin e administrimit të rrezikut, ky funksion mund t'i ngarkohet një drejtuesi ekzekutiv tjetër në bankë, me kushtin që të mos ketë konflikt interesi midis funksioneve të mbajtura nga ky i fundit.

4. Drejtuesi i strukturës/njësisë së administrimit të rrezikut raporton në mënyrë periodike në këshillin drejtues, te drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i bankës dhe në komitetin e rrezikut.

5. Punonjësit e strukturës/njësisë së administrimit të rrezikut duhet të kenë eksperiencën e mjaftueshme dhe kualifikimet e nevojshme për produktet e tregut dhe teknikat e matjes së rreziqeve për të gjitha linjat e biznesit të bankës dhe të gjitha rreziqet, me të cilat përballet banka gjatë aktivitetit të saj.

6. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut kryen analiza sasiore dhe cilësore të elementeve të rrezikut, me qëllim identifikimin e ekspozimit të rrezikut potencial, duke dhënë edhe konsideratat e përshtatshme për bankën.

7. Roli i strukturës/njësisë së administrimit të rrezikut duhet të jetë i qartë dhe transparent në drejtim të përgjegjësive të personelit në lidhje me rreziqet.

8. Bankat dokumentojnë bashkëveprimin periodik midis strukturës/njësisë së administrimit të rrezikut dhe këshillit drejtues.

Neni 14
Funksioni i përputhshmërisë

1. Bankat duhet të kenë një drejtues ekzekutiv, që kryen funksionin e identifikimit, koordinimit dhe të administrimit të rrezikut të përputhshmërisë së bankës.

2. Përgjegjësia kryesore e strukturës/njësisë, që përmbush funksionin e përputhshmërisë së bankës është asistimi/ndihmesa i/e drejtuesve ekzekutivë të bankës, në administrimin efektiv të rrezikut të përputhshmërisë.

3. Struktura/njësia e përputhshmërisë këshillon drejtuesit ekzekutivë të bankës, lidhur me përputhshmërinë me ligjet, rregullat dhe standardet, duke e informuar atë në vazhdimësi, mbi zhvillimet në këtë fushë, si dhe në veçanti kryen/përmbush detyrat e mëposhtme:

a) edukimin dhe trajnimin e personelit për çështjet e përputhshmërisë, duke shërbyer dhe si pikë kontakti brenda bankës për çështje apo pyetje të personelit lidhur me përputhshmërinë;

b) hartimin e udhëzimeve të brendshme për zbatimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të standardeve nëpërmjet politikave dhe procedurave apo dokumenteve të tjera, si: manualet e përputhshmërisë, kodet e brendshme të etikës dhe udhëzimet praktike;

c) identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e rreziqeve të përputhshmërisë në veprimtarinë e bankës, duke përfshirë produktet dhe praktikat e reja, tipat e linjave të reja të propozuara të veprimtarisë ose të marrëdhënieve me klientët dhe ndryshimet e rëndësishme në këto marrëdhënie;

d) matjen e rrezikut të përputhshmërisë duke përdorur treguesit e performancës (të tillë si: rritja e numrit të ankesave të klientëve, parregullsitë në pagesa etj.), me qëllim vlerësimin e këtij rreziku;

e) vlerësimin e përshtatshmërisë së procedurave dhe rregulloreve të përputhshmërisë, si dhe vlerësimin e mangësive të identifikuara, duke mundësuar edhe propozime për amendime;

f) monitorimin, testimin dhe raportimin e rezultateve nga testimi i mjaftueshmërisë së përputhshmërisë, sipas procedurave të sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut, duke evidentuar edhe ndryshimet në profilin e rrezikut të përputhshmërisë, mbështetur në treguesit e performancës, shkeljeve dhe/ose mangësive të identifikuara dhe të masave korrigjuese të ndërmarra;

g) krijimin e një kulture inkurajuese dhe të përshtatshme për komunikimin/sinjalizimin nga ana e punonjësve të bankës, të mospërputhshmërisë me rregullat, procedurat, operacionet etj., duke siguruar njëkohësisht konfidencialitetin dhe mbrojtjen e këtyre të fundit (punonjësve).

4. Struktura/njësia e përputhshmërisë mund të kryejë dhe detyra të tjera të veçanta, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të bankës (të tilla si ato të parandalimit të pastrimit të parave etj.), si dhe mban lidhje me Bankën e Shqipërisë dhe/ose autoritete të tjera të mbikëqyrjes së veprimtarisë financiare, ekspertin kontabël të autorizuar etj.

5. Struktura/njësia e përputhshmërisë kryen detyrat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet rregullative të bankës, mbështetur në një program pune, që përcakton aktivitetet e planifikuara, të tilla si zbatimi dhe rishikimi i politikave, procedurave të veçanta të rrezikut të përputhshmërisë, vlerësimet, testet e përputhshmërisë dhe edukimin e trajnimin e personelit për çështje të përputhshmërisë.

6. Programi i strukturës/njësisë së përputhshmërisë duhet të jetë i bazuar/fokusuar te rreziku dhe duhet të rishikohet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të sigurohet që ky program mbulon të gjitha linjat e biznesit/veprimtarisë së bankës dhe siguron koordinimin midis funksioneve të administrimit të rrezikut.

Neni 15
Politikat e shpërblimit

1. Këshilli drejtues, në përputhje me strategjinë, objektivat afatgjatë të veprimtarisë së bankës dhe ecurinë e saj, përcakton qartë dhe miraton politikat e shpërblimit të bankës.

2. Këshilli drejtues përcakton skemat dhe masën e shpërblimit në përputhje dhe në funksion të profilit të rrezikut. Për këtë qëllim, këshilli drejtues mund të asistohet nga një komitet i krijuar prej tij (Komiteti i Shpërblimeve).

3. Këshilli drejtues siguron që anëtarët e komitetit të shpërblimeve të jenë drejtues joekzekutivë dhe të kenë njohuri mbi politikat e shpërblimeve, mbi stimujt që mund të jenë parashikuar në kontratën e punës dhe rreziqet që mund të lindin nga këto kontrata.

4. Komiteti i shpërblimeve punon ngushtësisht me komitetin e rrezikut për të vlerësuar treguesit, që mund të përdoren si stimuj për përcaktimin e shpërblimeve dhe siguron rishikimin mbi baza vjetore të shpërblimeve, bazuar në objektivat afatgjatë të bankës, strategjinë e rrezikut dhe performancën.

5. Këshilli drejtues synon që politikat e shpërblimit të nxisin administrimin efektiv të rrezikut dhe të mos inkurajojnë marrjen e rrezikut përtej tolerancës së rrezikut të përcaktuar nga banka.

6. Politikat e shpërblimit, të hartuara dhe miratuara nga këshilli drejtues, mbulojnë të gjitha format e shpërblimit, duke përfshirë pagën, përfitime të tjera financiare dhe materiale dhe përfitimet nga pjesëmarrjet në skemat e pensioneve vullnetare për kategoritë e personelit të përcaktuara në vijim:

a) drejtuesit ekzekutivë të bankës;

b) punonjësit e njësisë së kontrollit të brendshëm;

c) punonjësit që ndërmarrin rrezik në detyrat që kryejnë (p.sh. tregtuesit e letrave me vlerë etj.);

d) të gjithë punonjësit, veprimtaria e të cilëve gjykohet se ka ndikim në profilin e rrezikut të bankës.

7. Këshilli drejtues rishikon periodikisht politikat e shpërblimit, me qëllim që të pasqyrojë në to ndryshimin e situatës financiare, në të cilën ndodhet banka dhe është përgjegjës për zbatimin e saj (politikës).

8. Këshilli drejtues, përveç rregullimeve *ex-ante* të rrezikut, përcakton procedura të tjera për të lidhur më mirë shpërblimin me nivelin e ndërmarrjes së rrezikut. Karakteristikë e rezultateve efektive të shpërblimit është simetria me rezultatet e rrezikut.

9. Këshilli drejtues vendos shpërblimin mbi bazën e elementeve të pandryshueshme dhe të ndryshueshme. Raporti midis elementit të pandryshueshëm dhe atij të ndryshueshme, në totalin e shpërblimit, ndryshon sipas kategorive të personelit të bankës.

10. Elementi i pandryshueshëm (fiks) i shpërblimit përfaqëson pjesën më të lartë në totalin e shpërblimit, me qëllim që të lejojë funksionimin e politikave elastike/fleksibël për elementin e ndryshueshme në shpërblim, duke përfshirë edhe mundësinë e mos pagimit të elementit të ndryshueshëm.

11. Elementi i ndryshueshëm përcaktohet në varësi të situatës financiare të bankës, performancës së përgjithshme të saj dhe performancës së njësive individuale të biznesit.

12. Elementi i ndryshueshëm mund të jetë në disa forma (bonuse, aksione etj.) dhe zvogëlohet në rastet kur banka ka performancë financiare negative ose hiqet në rastet kur ajo (banka) rezulton me humbje.

13. Bankat publikojnë në raportin e tyre vjetor, politikat e shpërblimit, shumat vjetore të agreguara të pagesave dhe shpërblimeve për këshillin drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë, si dhe format e shpërblimit të tyre, duke shpjeguar dhe argumentuar përputhshmërinë e këtyre pagesave me politikat e administrimit të rrezikut, profilin e rrezikut, të përcaktuar sipas objektivave afatgjatë të bankës, si dhe parimeve të përcaktuara në këtë nen.

KREU IV
KRITERET PËR KUALIFIKIMET, PËRVOJËN DHE KËRKESAT PËR DOKUMENTACIONIN E MIRATIMIT TË ADMINISTRATORËVE

Neni 16
Kriteret për kualifikimet dhe përvojën

1. Administrator i bankës mund të jetë individi me reputacion të lartë etik dhe profesional, me kualifikim dhe përvojë profesionale në drejtim.

2. Kualifikimi dhe përvoja profesionale në drejtim duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankave, sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Administratorët e propozuar zotërojnë kualifikim dhe përvojë profesionale të mjaftueshme dhe të përshtatshme, në rastet kur plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) zotërojnë diplomë universitare ose minimalisht kanë kryer programin e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë (në rastin e administratorëve, shtetas shqiptarë) në ekonomi ose jurisprudencë, si dhe kanë përvojë (kanë punuar) të paktën 5 (pesë) vjet në një nga sektorët e mëposhtëm:

i) sistemi bankar/financiar;

ii) administrimi i rrezikut në tregjet financiare;

iii) administrimi financiar;

iv) auditivi;

v) mbikëqyrja bankare/financiare;

vi) eksperienca ligjore ose akademike e lidhur me tregjet financiare; ose

b) zotërojnë diplomë universitare në një fushë tjetër të ndryshme nga ajo e shkencave ekonomike ose të jurisprudencës dhe kanë përvojë në sektorin bankar të paktën 5 vjet.

4. Administratorët e propozuar për pozicionin e anëtarit të këshillit drejtues ose të drejtorisë, përveç kritereve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, do të konsiderohet se zotërojnë përvojë drejtimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në rastet kur plotësojnë edhe të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

a) kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 3 (tre) vjet në institucione financiare që veprojnë në tregun financiar të brendshëm ose të jashtëm;

b) kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 3 (tre) vjet në një autoritet mbikëqyrës të tregut bankar/financiar në Shqipëri ose në një shtet tjetër;

c) kanë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 5 (pesë) vjet në persona juridikë të ndryshëm nga ata të përmendur në shkronjat "a" dhe "b" të këtij paragrafi.

5. Në kategorinë e administratorëve - anëtarë të drejtorisë dhe drejtues ekzekutivë - përfshihen, por pa u kufizuar:

a) drejtori i përgjithshëm;

b) zëvendësdrejtori/ët i përgjithshëm; si dhe

c) drejtorët ekzekutivë që janë përgjegjës për funksionet e mëposhtme:

i) origjinimi (shitja) e kredisë;

ii) investimet dhe tregtimi i instrumenteve për llogari të bankës;

iii) vlerësimi dhe kontrolli i agreguar i rreziqeve;

iv) sigurimi i përputhshmërisë;

v) parandalimi i pastrimit të parave;

vi) menaxhimi i operacioneve;

vii) mbikëqyrja e rrjetit të degëve;

viii) planifikimi, buxhetimi, ndjekja dhe raportimi financiar;

ix) kontrolli financiar;

x) menaxhimi i sistemeve elektronike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

6. Në varësi të natyrës, madhësisë dhe kompleksitetit të bankës, një drejtues ekzekutiv mund të jetë përgjegjës për më tepër se një nga funksionet e mësipërme. Banka, në rastet kur përgjegjësia për ndonjë nga funksionet e mësipërme është e shpërndarë te disa drejtues, përcakton drejtuesin që ka përgjegjësinë kryesore për këtë funksion.

Neni 17

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimin e administratorëve

1. Banka paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë për marrjen e miratimit paraprak për administratorin përkatës, të shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në përputhje me pikën 2 ose 3 të këtij neni.

2. Dokumentet e mëposhtme, të shoqëruara me formularët e plotësuar sipas anekseve të kësaj rregulloreje, i bashkëngjiten kërkesës:

a) vendimi i organit kompetent mbi propozimin për emërimin e administratorit përkatës;

b) dokumenti i identifikimit;

c) diploma e arsimit të lartë;

d) dokumentet që vërtetojnë kualifikime të tjera të administratorit të propozuar;

e) të dhëna të detajuara për veprimtarinë tregtare dhe për bizneset e tij për 5 (pesë) vitet e fundit, duke përfshirë dhe informacionin për pjesëmarrjet influencuese;

f) të paktën një rekomandim lidhur me aftësinë profesionale, të lëshuar nga eprorë, punëdhënës të mëparshëm apo akademikë;

g) një përshkrim të detajuar të punës për pozicionin që do të mbajë administratori i propozuar;

h) deklaratë personale në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;

i) deklarata personale e administratorit të propozuar, se gjatë punësimit të mëparshëm nuk ka kryer veprimtari sipas përcaktimeve në nenin 41 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", e plotësuar sipas formularit të aneksit nr. 2 të kësaj rregulloreje;

j) për administratorët e propozuar si anëtarë të këshillit drejtues, deklaratë personale për interesat privatë, sipas përcaktimeve të nenit 44 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (sipas aneksit 3 të kësaj rregulloreje);

k) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, që certifikojnë se:

i) personi nuk është në ndjekje penale;

ii) personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii) personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë);

iv) personi nuk ka detyrime pasurore të pashlyera (nga zyra/t e përmbarimit gjyqësor).

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Banka, në rastin kur individi i propozuar për administrator është një shtetas i huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, në rast se është e aplikueshme, paraqet në Bankën e Shqipërisë dhe lejen e tij të qëndrimit dhe të punës, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt".

4. Për administratorin shtetas i huaj, në rast se është e aplikueshme, vërtetimet e parashikuara në shkronjën "k" të pikës 2 të këtij neni do të paraqiten të lëshuara dhe nga organet kompetente të vendit të tij.

5. Dokumentacioni i përcaktuar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noteruar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, ai legalizohet nga autoritetet përgjegjëse.

6. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 18

Miratimi i administratorëve

1. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar pasi vlerëson reputacionin dhe kualifikimet mbi bazën e:

a) dokumenteve të paraqitura në përputhje me pikën 2 të nenit 17 të kësaj rregulloreje;

b) dokumenteve ose informacioneve të tjera që zotëron Banka e Shqipërisë;

c) gjetjeve (konkluzioneve, përfundimeve) të vetë Bankës së Shqipërisë;

d) kur çmohet e nevojshme dhe mbi bazën e një interviste të zhvilluar nga Banka e Shqipërisë me administratorin e propozuar.

2. Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me dhënien e miratimit paraprak për emërimin e administratorit shtetas të huaj do të kryhet në dy faza, si më poshtë:

a) Në fazën e parë, Banka e Shqipërisë shpreh moskundërshtimin e saj për emërimin e administratorit shtetas të huaj kur, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 17 të kësaj rregulloreje, krijon bindjen se përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 16 të saj.

b) Në fazën e dytë, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për emërimin e administratorit shtetas të huaj, pas plotësimit të dokumentacionit në përputhje me pikën 3 të nenit 17 të kësaj rregulloreje.

3. Banka e Shqipërisë refuzon miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar, kur mbi bazën e vlerësimeve të saj rezulton se administratori i propozuar nuk plotëson kushtet dhe kriteret e vendosura në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në këtë rregullore.

4. Në rastin e refuzimit të kërkesës për miratimin paraprak për emërimin e administratorit të propozuar, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

Neni 19
Miratimi në rast ndryshimi të pozicionit të administratorëve

1. Bankat, për çdo riemërim të administratorëve në një pozicion të ndryshëm nga ai ekzistues, por që vazhdon të ruajë cilësinë e administratorit në kuptim të pikës 19 të nenit 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, paraqesin në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim për miratimin e këtij riemërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e emërimit sipas shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 17 të kësaj rregulloreje;

b) CV-në e plotësuar sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

c) një përshkrim i detajuar i punës për pozicionin e ri që do të mbajë administratori i propozuar.

2. Banka e Shqipërisë mund të refuzojë dhënien e miratimit paraprak për riemërimin e administratorit sipas pikës 1 të këtij neni, kur mbi bazën e vlerësimeve të saj çmon se kualifikimet dhe përvoja e tij nuk janë të përshtatshme me pozicionin e ri si administrator.

Neni 20
Largimi i administratorëve

Bankat njoftojnë Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për largimin e administratorëve të tyre, duke dhënë me shkrim arsyet përkatëse.

KREU V
MARRËVESHJET ME TË TRETËT PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE DHE PËRGJEGJËSIVE PËR ADMINISTRIMIN DHE DREJTIMIN E BANKËS

Neni 21
Kriteret në përfundimin e marrëveshjeve me të tretët

1. Banka, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të përfundojë me të tretët marrëveshje për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive për administrimin dhe drejtimin e saj.

2. Banka, për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive nga të tretët:

a) harton dhe miraton një politikë për ushtrimin dhe kontrollin në mënyrë të përshtatshme të funksioneve dhe përgjegjësive nga të tretët;

b) siguron që vijimësia e veprimtarisë të saj, cilësia e shërbimeve dhe reputacioni i saj, nuk cenohen apo komprometohen nga transferimi i këtyre funksioneve dhe përgjegjësive;

c) siguron që ofruesi i shërbimit ka reputacionin dhe eksperiencën e duhur, si dhe një situatë financiare të qëndrueshme;

d) siguron që sistemi i kontrollit të brendshëm të përfshijë edhe funksionet dhe përgjegjësitë e deleguara të tretëve;

e) përcakton kriteret dhe harton metodat dhe procedurën për të ndjekur administrimin e rrezikut që rrjedh nga transferimi i funksioneve apo përgjegjësive;

f) sigurohet që ofruesi i shërbimit do të ruajë konfidencialitetin/sekretin e informacionit profesional të bankës dhe të klientëve, ndaj rrezikut të njohjes prej personave të paautorizuar;

g) sigurohet që marrëveshjet me të tretët nuk e zvogëlojnë aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet ndaj klientëve ose të pengojnë mbikëqyrjen efektive nga Banka e Shqipërisë.

3. Banka nuk mund të përfundojë me të tretët marrëveshje për të transferuar ushtrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm dhe/ose për ushtrimin e veprimtarive bankare ose financiare të përcaktuara në nenin 54 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

4. Banka, pa miratimin e Bankës së Shqipërisë, mund të kontraktojë dhe nënshkruajë marrëveshje me palë të treta për shërbimet e mëposhtme:

a) telefoni;

b) shërbime të informacionit të tregut, si: *Bloomberg, Moody's, Standard & Poors* etj.;

c) rrjetet e infrastrukturës së përbashkët, si: *VISA, Mastercard* etj.;

d) funksione, të cilat ajo nuk mund t'i kryejë vetë, si: shërbime këshilluese, opinione juridike, vlerësime të pavarura etj.;

e) të tilla që përgjithësisht konsiderohen me rrezik të ulët, si: shërbimi postar, shtypshkrimet, blerje mallrash e pajisjesh etj.

Neni 22

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për marrjen e miratimit paraprak, për përfundimin e marrëveshjeve me të tretët

1. Banka, me qëllim marrjen e miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë për marrëveshjet që do të përfundojë me të tretët për transferimin e funksioneve dhe përgjegjësive për drejtimin e saj, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) projektmarrëveshjen e miratuar nga palët, e cila ndër të tjera përmban:

i) qëllimin e marrëveshjes;

ii) funksionet dhe përgjegjësitë që do të transferohen;

iii) marrëdhënien midis bankës dhe ofruesit të shërbimit (të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve);

iv) kushtet dhe/ose procedurat për zgjidhjen e marrëveshjes;

v) mënyrën dhe periodicitetin e raportimit nga ofruesi i shërbimit për bankën, lidhur me mbarëvajtjen e realizimit të shërbimit etj.;

b) një vlerësim për pritshmërinë e zbatimit të marrëveshjes lidhur me:

i) efektet e kësaj marrëveshjeje në qëndrueshmërinë financiare, reputacionin dhe veprimtarinë e bankës;

ii) performancën e pritshme të ofruesit të shërbimit;

iii) kostot dhe përfitimet që do të rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes;

c) aktet e brendshme lidhur me mënyrën dhe procedurat e zhvillimit të funksioneve dhe përgjegjësive të transferuara;

d) planin e vazhdimësisë (vijimësisë) së veprimtarisë/ve;

e) dokumentacionin me të dhënat identifikuese për ofruesin e shërbimeve, si më poshtë:

i) statutin e shoqërisë;

ii) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person juridik (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);

iii) ekstraktin e Regjistrit Tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të për të cilin/at është lidhur marrëveshja (për personat juridikë të huaj – aktet e barasvlershme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);

iv) për administratorët e propozuar, dokumentacionin e parashikuar sipas kërkesave të pikës 2 të nenit 17 të kësaj rregulloreje;

f) vërtetimin nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale të vitit të fundit financiar për ofruesin e shërbimit;

g) bilancin kontabël dhe pasqyrat financiare të ofruesit të shërbimit për vitin e fundit, të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar.

2. Dokumentacioni sipas pikës 1 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noteruar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, ai legalizohet nga autoritetet përgjegjëse.

3. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23
Të tjera

Bankat, si pjesë të raportit vjetor të tyre, publikojnë edhe një deklaratë gjithëpërfshirëse, koherente dhe përshkruese, mbi rregullat dhe procedurat kryesore që ato (bankat) zbatojnë, në lidhje me parimet bazë të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv, në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre.

Neni 24
Të fundit

Aneksi 1, aneksi 2 dhe aneksi 3, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, janë pjesë përbërëse e kësaj të fundit.

ANEKSI 1
INFORMACION PËR KANDIDATIN PËR ADMINISTRATOR BANKE
(Informacioni i dhënë konsiderohet sekret nga Banka e Shqipërisë.)

1.	EMRI DHE SELIA E BANKËS	
2.	INFORMACION PERSONAL	
Emri dhe mbiemri		
Adresa e banimit		
Data dhe vendi i lindjes		
Shtetësia		
Numri i telefonit të punës		
Numri i telefonit të shtëpisë		
Adresa e e-mail-it		
3.	KUALIFIKIMI ARSIMOR (Ju lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha institucionet arsimore që keni ndjekur, kohëzgjatjen e pjesëmarrjes, datën e diplomimit dhe titujt akademikë)	
4.	NIVELI I NJOHJES SË GJUHËVE TË HUAJA (Ju lutemi listoni gjuhët dhe nivelin e njohjes së tyre)	
5.	TRAJNIME TË AVANCUARA (Ju lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha kurset, periudhat, temat e kursit, organizatorët)	
6.	EKSPERIENCA NË PUNË (Ju lutemi listoni në mënyrë kronologjike të gjitha punësimet e mëparshme. Titullin e pozicionit dhe kohëzgjatjen e punësimit, si dhe detyrat e kryera për secilën)	
	Periudha e punësimit (muaj/vit – muaj/vit)	
	Pozicioni (emërtimi i vendit tuaj të punës)	
	Përgjegjësitë (të detajuara)	
	Arsyet e largimit	Dorëheqje !___! Shkurtim i vendit të punës !___! Dalje në pension !___! Përfundimi i kontratës !___! Pushim nga puna !___! Të tjera !___! Specifiko
7.	Emrin, pozicionin, adresën e dy personave në sektorin bankar apo financiar, të cilët mund të shprehin opinionet e tyre lidhur me kompetencën profesionale dhe integritetin personal të kandidatit. (Nëse këta persona nuk mbajnë më pozicionet e referuara në rregullore specifikoni kur dhe ku ata i kanë pasur këto pozicione)	1. 2.
8.	A keni ju ose persona të lidhur me ju, përcaktuar sipas ligjit për bankat, ndonjë marrëdhënie financiare me bankën (kredi, garanci etj.)? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	
9.	A keni ju ose persona të lidhur me ju, përcaktuar sipas ligjit për bankat, pjesëmarrje ose ndonjë interes tjetër financiar me bankën? Nëse “po”, ju lutemi citojini ato.	

10.	A keni ju ose persona të lidhur me ju, përcaktuar sipas ligjit për bankat, pjesëmarrje aksionere ose ndonjë interes tjetër financiar me ndonjë bankë tjetër ose kompani? Nëse "po", ju lutemi citojini ato.	
11.	A jeni drejtues ose anëtar i bordit drejtues ose përfaqësues ligjor apo merrni pjesë në ndonjë mënyrë tjetër në krijimin dhe implementimin e politikave të biznesit në ndonjë bankë tjetër, subjekt financiar jobankë apo shoqëri kursim-krediti, ose në ndonjë institucion tjetër financiar apo shoqëri tregtare? Nëse "po", ju lutemi citojini ato.	
12.	A ka raste në pjesëmarrjet tuaja si drejtues i një banke, shoqërie tregtare apo institucioni financiar ku ju keni marrë pjesë në hartimin dhe implementimin e politikave të biznesit, ku të jeni ndeshur me vështirësi financiare që kanë rezultuar me fillimin e procedurave të rehabilitimit apo falimentimit kundrejt këtyre shoqërive tregtareve apo institucioneve? Nëse "po", lutemi listoni.	
13.	A keni qenë ndonjëherë i dënuar për kryerjen e një ose disa veprave kriminale referuar kërkesave të kësaj rregulloreje? Nëse jeni qytetar i huaj ose jetoni jashtë Republikës së Shqipërisë, a jeni dënuar jashtë për akte kriminale? Nëse "po", lutemi listojini.	
14.	A ka ndodhur që banka apo institucione financiare, në të cilat ju keni pasur pozicion drejtues dhe keni qenë të përfshirë në hartimin dhe implementimin e politikave të biznesit, të ketë qenë subjekt i masave ndreqëse (ndëshkuese) ose t'i jetë revokuar licenca për të vepruar nga institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e bankave, shoqërive të sigurimit dhe institucioneve të tjera financiare të tregut? Nëse "po", ju lutemi shpjegoni në mënyrë të plotë.	
15.	A ju është refuzuar apo revokuar ndonjëherë miratimi për mbajtjen e një pozicioni drejtues apo kryerjen e aktiviteteve në një fushë të caktuar operacionale? Nëse "po", ju lutemi të shpjegoni në mënyrë të plotë.	
16.	Sipas opinionit tuaj, ekziston ndonjë fakt apo rrethanë tjetër që mund (të gjykohet i arsyeshëm) të konsiderohet i rëndësishëm për vlerësimin e përshtatjes tuaj për pozicionin e administratorit të bankës (për shembull fakte dhe rrethana që lidhen me kualifikimet tuaja profesionale, vështirësi financiare ose konflikt interesi)? Nëse "po", ju lutemi listoni.	

17.	A është nisur ndonjëherë procedurë falimentimi kundrejt pronës tuaj? Nëse "po", shpjegoni në mënyrë të plotë.	

Unë deklaroj që të gjitha përgjigjet e mësipërme janë të vërteta dhe të plota. Ato janë dhënë bazuar në dijeninë time dhe unë nuk kam fshehur ndonjë informacion që mund të influencojë vendimin e Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, unë do të informoj menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të mundshëm që mund të ketë efekt në dhënien e miratimit për emërimin tim si administrator.

Vendi dhe data: Firma e kandidatit

ANEKSI 2
DEKLARATË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", deklaroj me përgjegjësinë time të plotë, si më poshtë vijon:

	Deklarata personale	**Po**	**Jo**
a)	është administrator i një shoqërie tjetër në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur kjo shoqëri është person i lidhur me të;		
b)	është aksioner i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i më shumë se 5 për qind të aksioneve me të drejtë vote, të një banke tjetër ose person i lidhur me të;		
c)	shërben ose ka shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 5-vjeçare paraardhëse si administrator i një banke, e cila ka qenë subjekt i procedurave të likuidimit të detyruar sipas dispozitave të këtij ligji;		
d)	shërben ose kanë shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës 12-mujore paraardhëse, në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;		
e)	është punonjës i Bankës së Shqipërisë;		
f)	është në ndjekje penale ose është shpallur fajtor nga gjykata për një vepër penale, për të cilin ligji parashikon dënimin me burgim;		
g)	ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese të detyrimeve dhe nuk është çliruar ende nga pagesa e detyrimeve të shkuara;		
h)	është ndëshkuar nga Banka e Shqipërisë gjatë 5 vjetëve të fundit për shkelje të rëndë të këtij ligji ose për zhvillim të veprimtarisë pa licencën përkatëse të lëshuar nga Banka e Shqipërisë;		
i)	është punonjës ose ortak i një shoqërie që është ekspert kontabël ose konsulent financiar i një banke ose i një dege të bankës së huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë;		
j)	detyrimet e tij tejkalojnë pretendimet dhe investimet e tij në bankë ose është i lidhur me persona juridikë, detyrimet e të cilëve ndaj bankës tejkalojnë pretendimet dhe investimet e tyre në bankë;		
k)	është kreditor dhe njëkohësisht vlera e përgjithshme e kredive të tij ndaj bankës tejkalon një të katërtën e aktiveve të saj.		

Vendi dhe data: Firma e kandidatit

ANEKSI 3
DEKLARATË*

Në bazë dhe për zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, deklaroj me përgjegjësinë time të plotë, si më poshtë vijon**:

		Bankën	**Aksionerët që ushtrojnë kontroll mbi bankën**	**Drejtuesit ekzekutivë**
a)	A keni interesa që burojnë nga marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta ose të tërthorta të çdo lloj natyre, me:			
b)	A keni interesa që burojnë nga marrëdhënie të tjera juridiko–civile, me:			
c)	A keni marrë dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale që lidhen me:			
d)	A keni bërë negocime të mundshme për punësim apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhënieje me interes privat në të ardhmen, me:			
e)	A jeni të angazhuar në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura që lidhen me:			
f)	A keni ju interesa që burojnë nga marrëdhënie familjare ose të bashkëjetesës me:	n.a.		

* Kjo deklaratë plotësohet vetëm nga administratorët e propozuar të bankës në pozicionin e anëtarit të këshillit drejtues.

**Ju lutemi plotësoni përgjigjet me "po" ose "jo".

Vendi dhe data: Firma e kandidatit

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 8.12.2012
Doli nga shtypi më 10.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 28 lekë